



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR
FORMATIN E DETAJUAR, MINIMUMIN E OBJEKTIT DHE TË PËRMBAJTJES SË
RAPORTIT TË AUDITIMIT, TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 38, datë 28.05.2015
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 151, datë 30.11.2017*

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore synon të përcaktojë elementët e nevojshëm mbi objektin, formën dhe përmbajtjen e raportit të auditimit bazuar në natyrën specifike të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për auditimin ligjor (auditimi) të shoqërive të sigurimit.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 126, pika 2, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”.

**Neni 3
Përmbajtja e raportit të auditimit**

1. Raporti i Auditimit duhet të përmbajë vlerësimin mbi pasqyrat financiare.
2. Shoqëria audituese duhet të shprehë opinionin e saj në letrën për drejtimin në seksione të veçanta për secilin nga elementët e mëposhtëm:
 - a. Vlerësim mbi përputhshmërinë me rregullat e administrimit të rrezikut;
 - b. Vlerësim mbi mjaftueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm;
 - c. Vlerësim mbi cilësinë dhe mjaftueshmërinë e sistemit të teknologjisë së informacionit;
 - d. Vlerësim mbi rregullësinë dhe saktësinë e raportimeve të depozituara pranë Autoritetit;
 - e. Raportin aktuarial mbi vlerësimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike.

Neni 4

Vlerësim mbi pasqyrat financiare

1. Shoqëria audituese auditon dhe vlerëson pajtueshmërinë e pasqyrave financiare të shoqërisë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar SNRF dhe legjislacionit në fuqi.
2. Shoqëria audituese duhet të kontrollojë dhe vlerësojë vërtetësinë e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe të shprehë opinionin e saj, në lidhje me:
 - a. Mbajtjen e vazhdueshme të kontabilitetit të shoqërisë së sigurimit, dokumentacionit të veprimtarisë së kësaj shoqërie, sipas kërkesave të Ligjit nr. 52, date 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
 - b. Mënyrën e vlerësimit të zërave të bilancit e atyre jashtë bilancit, si edhe politikat kontabël të shoqërisë së sigurimit për vlerësimin e këtyre zërave.
3. Opinioni i shoqërisë audituese duhet të evidentojë të metat apo mangësitë e konstatuara gjatë auditimit sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, si dhe rreziqet ndaj të cilave mund të ekspozohet shoqëria e sigurimit.

Neni 5

Vlerësim mbi përputhshmërinë me rregullat e administrimit të rrezikut

1. Shoqëria audituese duhet të kontrollojë dhe të vlerësojë rregullat, politikat dhe procedurat e shoqërisë për identifikimin, matjen, monitorimin dhe administrimin e rreziqeve ndaj të cilëve është e ekspozuar shoqëria e sigurimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, si dhe të shprehë opinionin e saj për zbatimin e rregullave të administrimit të rrezikut.
2. Opinioni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të përmbajë të paktën:
 - a. Informacion mbi identifikimin, vlerësimin, mbikëqyrjen, administrimin dhe raportimin e llojeve të rrezikut në të cilën është e ekspozuar, ose mund të ekspozohet shoqëria e sigurimit gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, në nivel të shoqërisë, si një e tërë dhe në nivel grupi. Ky informacion të detajohet lidhur me:
 - i. Transaksionet me palë të lidhura;
 - ii. Transaksione të cilat nuk kanë lidhje me veprimtarinë direkte të sigurimit dhe interesin e policëmbajtësve;
 - iii. Aktive të bllokuara apo të lëna si kolateral për palë të treta;
 - iv. Mashtrim apo përvetësim, vjedhje, pastrim parash apo financim të terrorizmit;
 - b. Vlerësimin e politikave dhe procedurave të shkruara që lidhen me sistemin e administrimit të rrezikut dhe zbatimin e tyre;
 - c. Mangësitë në administrimin e çdo rreziku;
 - d. Vlerësimin mbi përshtatshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në lidhje me administrimin e çdo rreziku;

- e. Vlerësimin mbi masat e ndërmarra nga shoqëria e sigurimit lidhur me rekomandimet e dhëna nga Komiteti i Auditimit të shoqërisë dhe nga auditimet e kryera në vitet e mëparshme.

Neni 6

Vlerësim mbi mjaftueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm

1. Shoqëria audituese duhet të kontrollojë, vlerësojë dhe të shprehë opinion mbi tërësinë e rregullave dhe parimeve të monitorimit dhe të vlerësimit të mjaftueshmërisë dhe efektivitetit të politikave, të procedurave dhe mekanizmave të kontrollit brenda një shoqërie dhe të cilësisë së operacioneve të veprimtarisë së saj, të kryera nga struktura e administrimit, drejtimit dhe kontrollit të saj, si dhe nga personat që kryejnë funksionet e kontrollit të brendshëm.
2. Shoqëria audituese duhet të kontrollojë dhe të vlerësojë efikasitetin e funksionit të auditimit të brendshëm.
3. Opinioni i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të përmbajë të paktën:
 - a. Një përshkrim të shkurtër të rregullave mbi funksionimin dhe detyrat e njësisë së auditimit të brendshëm;
 - b. Një vlerësim mbi efikasitetin e funksionit të auditimit të brendshëm;
 - c. Një vlerësim mbi veprimtarinë e Komitetit të Auditimit, si edhe të marrëdhënieve të ndërsjella midis këtij komiteti dhe njësisë së auditimit të brendshëm;
 - d. Vlerësimin mbi masat e ndërmarra nga shoqëria e sigurimit lidhur me rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm i shoqërisë.

Neni 7

Vlerësim mbi cilësinë dhe mjaftueshmërinë e sistemit të teknologjisë së informacionit

1. Shoqëria audituese duhet të kontrollojë, vlerësojë dhe të shprehë opinion mbi cilësinë dhe mjaftueshmërinë e sistemit të informacionit.
2. Opinioni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet do të përmbajë të paktën:
 - a. Vlerësim në lidhje me cilësinë dhe mjaftueshmërinë e sistemit të teknologjisë së informacionit në përdorimin e metodave dhe procedurave për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut;
 - b. Vlerësim mbi përshtatshmërinë e administrimit të sistemit të teknologjisë së informacionit, duke evidentuar mangësitë e konstatuara dhe rreziqet e sistemit;
 - c. Vlerësimin mbi masat e ndërmarra nga shoqëria e sigurimit lidhur me rekomandimet e dhëna nga shoqëria audituese në vitet e mëparshme.

Neni 8

Vlerësim mbi rregullsinë dhe saktësinë e raportimeve të dorëzuara pranë Autoritetit

1. Shoqëria audituese duhet të kontrollojë, vlerësojë dhe të shprehë opinion mbi rregullsinë dhe saktësinë e raportimeve të dorëzuara pranë Autoritetit.

2. Shoqëria audituese duhet të konsiderojë edhe gjetjet e konstatuara dhe rekomandimet përkatëse të Autoritetit gjatë ushtrimit të funksionit të tij mbikëqyrës.

Neni 9

Raporti aktuarial mbi vlerësimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike

1. Shoqëria audituese duhet të kontrollojë, vlerësojë dhe të shprehë opinion mbi mjaftueshmërinë e provigjoneve teknike të shoqërisë së sigurimit, duke u bazuar në kërkesat ligjore në fuqi dhe në teknikat e duhura aktuariale.
2. Opinioni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të përmbajë të paktën:
 - a. Shumën e provigjoneve teknike në fillim dhe në fund të vitit dhe ndryshimin në shumën e provigjoneve teknike gjatë vitit;
 - b. Përshkrimin e metodave të zbatuara nga ana e shoqërisë së sigurimit për llogaritjen e provigjoneve teknike, si edhe devijime (nëse ka të tilla) në llogaritjen e tyre dhe efektet e tyre në rezultatin financiar të shoqërisë së sigurimit;
 - c. Vlerësim mbi masat e ndërmarra nga shoqëria e sigurimit lidhur me rekomandimet e dhëna në auditimet e mëparshme;
 - d. Vlerësim mbi nivelin e provigjoneve teknike, i cili do të përfshijë vlerësimin e nivelit të këtyre provigjoneve dhe bazat për opinionin pozitiv, negativ apo opinion me rezerva.

Neni 10

Dispozita të përgjithshme

1. Përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe të shoqërisë audituese zhvillojnë takime të rregullta periodike:
 - a. Para, gjatë ose pas përfundimit të procesit të auditimit të kryer nga shoqëria audituese;
 - b. Në rrethana kur merren vendime të rëndësishme për shoqërinë.
2. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë audituese çdo informacion që gjykon të nevojshëm në ushtrimin e funksionit të tij mbikëqyrës. Shoqëria audituese i vë në dispozicion Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të gjithë informacionin e nevojshëm të kërkuar prej tij.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.